

## FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[ Data : 16.07.2018]

**Për: Bashkimin e Operatoreve Ekonomike "Besta" shpk (63%) & "Fled" shpk (20%) & "Totila" shpk (17%), perfaqesuar nga shoqeria "Besta" shpk, me adrese: ndertese dy kateshe, kati I dyte, Njesia Administrative Poshnje, Ura Vajguore, Berat, me NIPT J62903182B.**

Procedura e prokurimit: **"Tender i Hapur"** me objekt : **"Rikonstruksioni i rrugeve te brendshme dhe rikualifikimi i hapësirave publike tek zona e plazhit tek Shkëmbi i kavajes, Bashkia Durrës"**.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **"Rikonstruksioni i rrugeve te brendshme dhe rikualifikimi i hapësirave publike tek zona e plazhit tek Shkëmbi i kavajes, Bashkia Durrës"**.

Numri i referencës së procedurës: **REF-69237-05-16-2018.**

Kohëzgjatja: brënda 10 muaj nga data e fillimit te punimeve.

Fondi limit: 372.584.260 (treqind e shtatëdhjetë e dy milion e pesëqind e tetëdhjetë e katër mijë e dyqind e gjashtëdhjetë) lekë pa tvsh. Fondi i akorduar për vitin 2018 është 124.294.167 lekë pa tvsh. Pjesa e mbetur është parashikuar për vitin 2019.

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **Datë 18.06.2018.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Nuk ka patur.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh:

NR	SHOQERIA	NIPTI	OFERTA PA TVSH PARA KONTROLLIT ARITMETIK
1	"VARAKU E" SHPK (39%)	J61902509S	212,856,809.00
	"VELLEZERIT HYSA" SHPK (61%)	K12911201C	
2	"BESTA" SHPK (63%)	J62903182B	228,121,762.00
	"FLED" SHPK (20%)	K17621104C	
	"TOTILA" SHPK (17%)	K13001010G	
3	"BAJRAMI N" SHPK (71%)	K02727202O	249,440,002.30
	"BLERIMI" SHPK (29%)	J62903384G	
4	"B 93" SHPK (45%)	J62903508R	249,814,814.00
	"BE - IS" SHPK (55%)	K71412003A	
5	"EURONDERTIMI 2000" SHPK (38.96%)	K02003001O	252,971,652.15
	"AGRI KONSTRUKSION" SHPK (53.41%)	K01725001F	
	"KACDEDJA" SHPK (7.63%)	K51712017A	
6	"LIQENI VII" SHPK (38%)	K01730502W	255,779,307.00
	"KUPA" SHPK (52%)	K51615512C	
	"NDERTIMI" SHPK (10%)	K11325002C	
7	"2T" SHPK	K01731001M	255,825,286.50
8	"ALBA KONSTRUKSION" SHPK	J61812013R	256,422,762.75
9	"LALA" SHPK (31%)	J76418903B	257,091,207.00
	"BIBA X" SHPK (30%)	K32618815N	
	"SHANSI INVEST" SHPK (23%)	J61924002T	
	"JODI KOMPANY" SHPK (16%)	J94824803M	
10	"G.P.G. COMPANY" SHPK	J64324443V	279,231,257.00
11	"AL ASFALT" SHPK (55%)	K81511508A	279,486,947.00
	"ALB KORCA 2002" SHPK (15%)	K34004003T	
	"EURO ALB" SHPK (15%)	K66613407H	
	"HTM" SHPK (15%)	K97006004D	
12	"HASTOCI" SHPK (50%)	J62028009B	307,551,502.00
	"BAMI" SHPK (50%)	J94416206R	
13	"FUSHA" SHPK	J61922018S	341,060,585.25
14	"K.M.K." SHPK		NUK KA PARAQITUR OFERTE

Pas vleresimit te dokumentacionit te paraqitur komisioni me unanimitet vendosi:

**1. Te skualifikoje bashkimit e Operatoreve Ekonomike "Varaku E" shpk (39%) dhe "Vellezerit Hysa" shpk (61%) pasi:**

Shoqeria "Varaku E" shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.1 per kualifikim lidhur me realizimin e puneve te ngjashme, pasi sipas perqindjes qe ka marre persiper duhet te kishte realizuar 72.653.930 leke punime te ngjashme pa tvsh nderkohe qe puna e deklaruar me objekt "Sistemim asfaltim unaza Erseke" ka vleren me tvsh 92.992.560 leke, vleren pa tvsh 77.493.800 leke dhe shoqeria "Varaku E" shpk ka realizuar 80% te punes ose 61.995.040 leke punime pa tvsh, duke mos plotesuar kushtin. Gjithashtu kjo pune nuk mund te merret ne konsiderate, pasi punimet kane filluar ne daten 25.05.2011 dhe kane perfunduar ne daten 25.05.2015, pra jashte afatit tre vjecar te kerkuar ne kerkesat per kualifikim.

Per kontraten "Rruga Paperr Banje" realizuar si JV me shoqerine "Vellezerit Hysa" shpk, nuk ka

paraqitur faturat tatimore per te vertetur kryerjen e 38,74% te punimeve qe ka marre persiper. Ne kete menyre kjo pune nuk mund te merret ne konsiderate.

Shoqeria “Vellezerit Hysa” shpk nuk ploteson kerkesen 2.2.4 per kualifikim lidhur me plotësimin e te gjitha detyrimeve e taksave dhe tarifave vendore, pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar ne tender, nuk ka paraqitur vertetim nga Bashkia Tirane, ku ushtron aktivitet qe nga muaji mars 2018 ne objektin “Ndertimi i rrugeve “Migjeni” dhe “Kadri Roshi” ne njesine administrative Kashar.

**2. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Bajrami N” shpk (71%) dhe “Blerimi” shpk (29%) pasi:**

Shoqeria “Blerimi” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.1 per kualifikim lidhur me realizimin e puneve te ngjashme, pasi per asnje nga punet e deklaruar nuk ka paraqitur faturat tatimore. Vetem per punen e deklaruar me objekt “Rikualifikim urban i parkut Aqif Pasha” ka paraqitur faturat e leshuara nga shoqeria “Bajrami N” por jo ato te leshuara nga shoqeria “Blerimi”, ne kundershtim me cka kerkohet ne kerkesen per kualifikim.

Shoqeria “Blerimi” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.3 per kualifikim lidhur me stafin, pasi ne tabelen e deklarimit te stafit ka deklaruar: Ing. Ndertimi Behxhet Uruci, Ing. Elektrik Sashenko Mahmutaj dhe Ing. Hidroteknik Arif Jaubelli, dhe nuk ka inxhinier topograf i cili eshte i domosdoshem per punimet qe ka marre persiper.

Shoqeria “Blerimi” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.5 per kualifikim lidhur me punesimin e mjekut, pasi nuk ka paraqitur asnje dokumentacion per kete qellim.

**3. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Eurondertimi 2000” shpk (38.96%), “Agri Konstruksion” shpk (53.41%) dhe “Kacdedja” shpk (7.63%) pasi:**

Shoqeria “Eurondertim 2000” shpk nuk ploteson kerkesat e pergjithshme per kualifikim pasi nuk ka paraqitur deklaraten perkatese. Gjithashtu kjo shoqeri nuk ka paraqitur deklaraten mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5, deklaraten mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7, deklaraten per pagesen e taksave vendore, deklaraten per mosangazhimin e inxhinierëve dhe deklaraten per mosangazhimin e mjeteve.

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete bashkim shoqerish.

**4. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Liqeni VII” shpk (38%), “Kupa” shpk (52%) dhe “Ndertimi” shpk (10%) pasi:**

Shoqeria “Kupa” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.3 per kualifikim lidhur me stafin, pasi, pervec arkitektit, inxhinieret e tjere te deklaruar jane te angazhuar ne realizimin e kontrates "Sistemim asfaltim i rruges Kastriot - Arras”, lidhur me FSHZH, kontrate e cila eshte ne proces zbatimi. Ne kete menyre edhe deklarata e bere ne zbatim te kerkeses 2.3.4 per kualifikim rezulton e rreme.

Shoqeria “Ndertimi” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.3 per kualifikim lidhur me stafin, pasi ka marre persiper punime kanalizimi e ujesjellesi dhe nuk ka te punesuar inxhinier hidroteknik, i domosdoshem

per kryerjen e ketyre punimeve.

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete bashkim shoqerish.

#### **5. Te skualifikoje Operatorin Ekonomik “2T” shpk pasi:**

Nuk ploteson kerkesen 2.3.3 per kualifikim lidhur me stafin, pasi ne stafin e propozuar mungon inxhinieri mekanik. Gjithashtu stafi i deklaruar eshte i angazhuar ne objektin "Rikonstruksioni rruges "Ura e Çoromit - Zhabiak - Ura e Çepanit", lidhur me FSHZH, kontrate e cila eshte ne proces zbatimi. Ne kete menyre edhe deklarata e bere ne zbatim te kerkeses 2.3.4 per kualifikim rezulton e rreme.

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete shoqeri.

#### **6. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Lala” shpk (31%), “Biba X” shpk (30%), “Jodi Company” shpk (16%), dhe “Shansi Invest” shpk (23%) pasi:**

Shoqeria “Lala” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.1 per kualifikim lidhur me realizimin e puneve te ngjashme, pasi puna e deklaruar “Ujesjellesi Sarande” nuk mund te konsiderohet si pune e ngjashme.

Shoqeria “Biba X” shpk nuk ploteson kerkesat e pergjithshme per kualifikim pasi, referuar vertetimit te leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve me nr. 2897 Prot, date 30.05.2018, rezulton se ka detyrime ne shumen 9.425.019 leke.

Shoqeria “Biba X” shpk nuk ploteson kerkesen 2.2.3 per kualifikim lidhur me detyrimet dhe taksat vendore pasi, referuar puneve te ngjashme te deklaruar, ka kryer aktivitet ne Shijak ne ndertimin e objektit “Rikonstruksion, sistemim dhe asfaltim sheshesh” ne vitet 2016-2018 dhe nuk ka paraqitur asnje dokument per likuidimin e detyrimeve vendore ne kete bashki, per kete periudhe.

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete bashkim shoqerish.

#### **7. Te skualifikoje Operatorin Ekonomik “KMK” shpk pasi nuk ka paraqitur oferte.**

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Bashkimin e Operatoreve Ekonomike "Besta" shpk (63%) & "Fled" shpk (20%) & "Totila" shpk (17%), perfaqesuar nga shoqeria “Besta” shpk, me adrese: ndertese dy kateshe, kati I dyte, Njesia Administrative Poshnje, Ura Vajgurore, Berat, me NIPT J62903182B** se oferta e paraqitur, me vlerë **228,121,762 (dyqind e njezet e tete milion e njeqind e njezet e nje mije e shtateqind e gjashtedhjete e dy)** lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**

- **Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 10, Tirana, Albania**
- **Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)**
- **Fax: 00355 4 2 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **27.06.2018**.

Ne daten 29.06.2018 paraqiti ankese shoqeria “2T”shpk. Ankeses ju kthye pergjigje ne daten 02.07.2018.

Ne daten 03.07.2018 paraqiti ankese shoqeria “Varaku”shpk. Ankeses ju kthye pergjigje ne daten 04.07.2018.

Ne daten 03.06.2018 paraqiti ankese shoqeria “Lala”shpk. Ankeses ju kthye pergjigje ne daten 04.07.2018.

Nuk jane paraqitur ankesa ne KPP.

